

INTEGRITETI



INTEGRITET DHE ETIKË

SEMPER VIGILE

> IPK.RKS-GOV.NET

IPK shtrihet në rajone



Inspektorati Policor hap zyrat rajonale në Gjilan dhe Prizren

INTEGRITETI



INTEGRITET DHE ETIKE

INTEGRITETI



INTEGRITET DHE ETIKE

SEMPER VIGILE

> IPK.RKS-GOV.NET

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLICA E KOSOVËS / VLADA E KOSOVËS
Ministria e Postës dhe Komunikimit
Ministry of Internal Affairs

Zyra Rajonale në Gjilan
Regional Office in Gjilan

IPK
shtrihet
në rajone

Inspektorati Policor hap zyrat rajonale në Gjilan dhe Prizren

info

zimp.ipk@rks-gov.net

Revista "Integriteti" është botim i Inspektoratit Policor të Kosovës

Divizioni për Marrëdhënie me Publikun dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar

Botues: Inspektorati Policor i Kosovës

Kryeredaktor:
Arbër BEKA

Bashkëpunëtorë:
Lulzim THAÇI
Shqiponje SOPI

Tel: +377 (0) 44 146 696
E-mail: arber.beka@rks-gov.net,
arberbeka@gmail.com, zimp.ipk@rks-gov.net

INTEGRITETI

4-6

SHISHANI:
Vullneti për të luftuar dukuritë negative nga ana e PK-së nuk mungon



PËRMBAJTJA

BASHKËPUNIMI ME QYTETARË

BASHKËPUNIMI ME QYTETARË NË FOKUS TË IPK-SË, 12-13

IPK SHTRIHET NË RAJONE

INSPEKTORATI POLICOR HAP ZYRAT RAJONALE NË GJILAN DHE PRIZREN, 14-15

PROJEKTI I BINJAKËZIMIT

INSPEKTORATI POLICOR SHKËMBEN PËRVOJAT ME HUNGARINË, 16-17

NËNTË VITE ME IPK

IPK SHËNON NËNTË VJETORIN E THEMELIMIT, 18-19

5

IPK pjesë e organizimit “Amerika me Kosovën”



RAPORTI I PECK-UT

RAPORTI I VLERËSIMIT TË PECK-UT KUNDËR KORRUPSIONIT, 20-21

“LINJA E KALTËR”

NË TËRË KOSOVËN, 22

FOTO LAJME, 23

8-9

Fuqizohet bashkëpunimi në fushën e kontrollit të brendshëm



PIKË SHITESË:

Mendimet, komentet, këndvështrimet e shprehura ose të përfshira në përmbajtje të këtij botimi nuk paraqesin medeomos politikat ose vështrimet zyrtare të IPK-së.

10-11

IPK përfundoi inspektimin përcjellës për zbatimin e rekomandimeve



SHISHANI: VULLNETI PËR TË LUFTUAR DUKURITË NEGATIVE NGA ANA E PK-SË NUK MUNGON

E kam theksuar shumë shpesh në shumë konferenca të organizuara për integritetin policor dhe po theksoj edhe tani, policia duhet të angazhohet shumë edhe nga aspekti vetjak. Sa më shpejt që është e mundur duhet ndryshuar kultura organizative, e cila sigurisht se s’duhet të jetë statike, por të ndryshojë me kohën në bazë të sfidave, duke përfshirë metoda të reja pune dhe forma të reja performance”

Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) ka filluar implementimin e projektit për regjionalizimin i cili përfshin në fazën e parë hapjen e tri zyrave rajonale me qëllim që të jetë sa më afër qytetarëve. Këto dhe detaje të tjera për lexuesit e revistës “Integriteti” i solli në një intervistë Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së - Fitim Shishani.

“Integriteti”: Z.Shishani, duke parë raportet periodike dhe komunikimin e IPK-së me publikun, sot ky institucion është ndër më të frekuentuarit nga qytetarët, ndoshta për shkak të misionit që ka?

Shishani: Dua të them që në fillim se profesionalizmi, objektiviteti, paanshmëria, transparenca, pra i tërë ky imazh që sot gëzon IPK-ja, është krijuar nga punonjësit e IPK-së nga trajnimet e shumta që kanë organizuar institucionet ndërkombëtare, sidomos ICITAP-i amerikan, nga segmentet e ndryshme këshilluese vendore e ndërkombëtare siç janë: EULEX-i, OSBE, mbi të gjitha nga një disiplinë vërtet reale,

etike e profesionale. Kjo më bën krenar me të gjithë punonjësit e IPK-së dhe angazhimet e tyre. Dua të them që në fillim se puna që bën IPK-ja, pra veprimtaria e saj, normalisht se nuk është shumë e pëlqyer, pasi ne jemi organ mbikëqyrës dhe rezultatet e punës sonë shpesh rezultojnë me suspendime, rekomandime për largim nga puna apo edhe me arrestime të punonjësve policorë, të cilët janë të thirrur të mbrojnë shtetin, rendin e ligjin, etikën dhe vlerat e organizatës policore. Por, ne kryejmë një mision fisnik për shtetin për qytetarët tanë, i cili është paraparë me Ligjin e IPK-së, Kushtetutën e vendit dhe me standardet ndërkombëtare. Më lejoni të theksoj edhe këtë gjë, të gjithë punonjësit e IPK-së çdoherë në punën e tyre janë të trajnuar ta kujtojnë betimin e dhënë, duke mos pasur kohë asnjëherë për komoditet apo për relaksim. Jam i vetëdijshëm se në institucionet tona shtetërore, pa e përjashtuar edhe Inspektoratin Policor të Kosovës, mund të ketë njerëz që nuk mund t’u bëjnë

ballë sfidave, volumit të punëve e ndoshta edhe respektimit rigoroz të rregullave ligjore, por ky është dallimi ndërmjet një punonjësi shtetëror, një zyrtari shtetëror nga një i punësuar i rëndomtë në ndonjë organ tjetër. Mendoj se të gjithë ne që udhëheqim shtetin tonë dhe që kemi marrë një detyrë me rëndësi, duhet ta dimë se duhet të kemi përgjegjësi, duhet ndonjëherë të raportojmë ndonjë sukses, duhet t’i arsyetojmë investimet që shteti i Kosovës dhe partnerët ndërkombëtarë i kanë bërë për institucionet të cilat ne i drejtojmë.

“Integriteti”: Sa është investuar në IPK gjatë këtyre viteve?

Shishani: Në IPK janë bërë investime të mëdha nga MPB-ja që nga viti 2011, pastaj nga partnerët tanë ndërkombëtar ICITAP-i, EULEX-i, OSBE-ja, DCAF-i etj. që t’i arrijmë këto standarde që sot i kemi. Qëllimi i punonjësve të IPK-së dhe i imi gjithashtu është që ne të mos biem nën këto standarde. Sukseset e IPK-së nuk janë evidentuar



Fitim Shishani
Kryeshafi i IPK-së

Profesionalizmi, objektiviteti, paanshmëria, transparenca, pra i tërë ky imazh që sot gëzon IPK-ja, është krijuar nga punonjësit e IPK-së nga trajnimet e shumta që kanë organizuar institucionet ndërkombëtare, sidomos ICITAP-i amerikan, nga segmentet e ndryshme këshilluese vendore e ndërkombëtare siç janë: EULEX-i, OSBE, mbi të gjitha nga një disiplinë vërtet reale, etike e profesionale. Kjo më bën krenar me të gjithë punonjësit e IPK-së dhe angazhimet e tyre.

vetëm nga mekanizmat vendor, por edhe ato ndërkombëtare. Në një raport vlerësimi të Këshillit të Evropës për përputhshmërinë e standardeve ndërkombëtare kundër korrupsionit, IPK-ja përmendet si një agjenci që duhet të shërbejë si shembull i mirë për institucionet e tjera në Kosovë.

“Integriteti”: A ka ndërmarrë IPK-ja masa të lehtësohet komunikimi me qytetarët e vendit?

Shishani: IPK-ja ka ndërmarrë shumë aktivitete që ndërlihen me fuqizimin e bashkëpunimit me qytetarët e vendit. Më lejoni t’i cek disa nga angazhimet konkrete të IPK-së si: projekti i “Linjës së Kaltër” - numri pa pagesë për qytetarët e vendit 080003333,

projekti i “Kutive të ankesave”, të cilat janë vendosur në 45 lokacione anekënd Republikës së Kosovës, përdorimi i teknologjisë informative duke përfshirë rrjetet sociale si “Facebook”, “Twitter”, si dhe mundësimi i ankesës në mënyrë elektronike nëpërmjet uebit tonë ipk rks-gov.net. Përveç këtyre, IPK-ja ka filluar t’i hapë disa zyra edhe në nivel të rajoneve. Shtrirja në nivelin lokal bëhet që IPK-ja të jetë me shërbimet e tyre sa më afër qytetarëve drejt një policie edhe më të përgjegjshme dhe llogaridhënëse në përputhje me standardet e larta ndërkombëtare.

Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) është duke menaxhuar me të gjitha rastet që janë në kuadër të fushëveprimit të saj me burimet njerëzore aktuale.

Sidoqoftë, në përputhje me misionin dhe vizionin e IPK-së për regjionalizimin ose hapjen e zyrave në disa rajone, në të ardhmen paraqitet nevoja për burime shtesë njerëzore.

Shfrytëzoj rastin t’i falënderoj përkrashtet e këtij projekti, MPB-në, sidomos Agjencinë e Regjistrimit Civil.

“Integriteti”: Z. Shishani, a kanë bërë ndonjëherë shkelje punonjësit e IPK-së që nga koha kur ju e kryesoni këtë institucion?

Shishani: Po, kanë ndodhur shkelje, bile edhe tërënd nga disa ish-pjesëtarë të IPK-së, mirëpo ne kemi treguar menjëherë se nuk tolerojmë shkelës të tillë të ligjit brenda organizatës sonë dhe pas ndërmarrjes së veprimeve

Vullneti për të luftuar dukuritë negative nuk mungon nga ana e PK-së. E kam theksuar shumë shpesh në shumë konferenca të organizuara për integritetin policor dhe po theksoj edhe tani, policia duhet të angazhohet shumë edhe nga aspekti vetjak. Sa më shpejt që është e mundur duhet ndryshuar kultura organizative, e cila sigurisht se s'duhet të jetë statike, por të ndryshojë me kohën në bazë të sfidave, duke përfshirë metoda të reja pune dhe forma të reja performance.

ligjore që na kanë takuar, ata sot nuk janë pjesë e IPK-së. Dua të theksoj një gjë, çdo kund në botë një udhëheqës, një menaxher, një lider nuk mund t'i parandalojë të gjitha gjërat negative të cilat mund të ndodhin, por e rëndësishme është kur e kupton për shkeljen, si vepron: Duke heshtur dhe duke e mbuluar të keqen, apo duke e luftuar atë? Ne (IPK-ja) kemi zgjedhur këtë të dytën. Nuk ka IPK-ja asgjë për të fshehur, sepse objektiviteti dhe transparencja do të na shoqërojnë çdoherë në secilin veprim të ndërmarrë nga ana jonë, prandaj mund të them, pavarësisht rezultateve të mëdha të të gjithë personelit tonë, asnjë individ nuk do të jetë i përkëdhelur. Kemi krijuar kushte shumë të mira për punë dhe do të vazhdojmë të punojmë.

“Integriteti”: Objekti i punës së IPK-së është parandalimi, zbulimi, argumentimi, etj. i veprave penale që kryhen nga Policia e Kosovës. Si institucion mbikëqyrës punës së policisë sa po arrini të përmbushni me sukses misionin tuaj?

Shishani: Sa iu përket rezultateve tona në lidhje me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit brenda policisë, mund t'u bëni një analizë raporteve vjetore të IPK-së të botuara vit pas viti. Megjithatë, qëllimi ynë primar është lufta e pakompromis kundër korrupsionit. Në këtë kontekst mund t'ju informoj se vetëm në vitin 2014 për vepra penale me elemente të korrupsionit IPK-ja i ka hetuar 83 vepra penale nga kapitulli i veprave penale

kundër korrupsionit dhe detyrës zyrtare etj. Nga muaji janar i vitit 2014 deri në muajin dhjetor në Inspektoratin Policor të Kosovës janë trajtuar 1 304 ankesa të ndryshme nga qytetarët dhe institucionet e ndryshme. Nga 1 304 ankesa që ka pranuar IPK-ja në vitin 2014, 233 nga to kanë qenë raste me elemente të veprës penale, të cilat janë hetuar nga Departamenti i Hetimeve. Në total ishin 305 punonjës të PK-së si subjekt i hetimit nga IPK-ja. Të paraqitur në përqindje, i bie që vetëm 3.4 për qind të punonjësve të PK-së ishin nën hetim apo 0.6 për qind më pak se vitin e kaluar. Masat dhe rekomandimet e dhëna nga IPK-ja gjatë vitit 2014, të cilat kanë ardhur si kërkesa dhe nevoja gjatë zhvillimit të hetimeve janë: 20 arrestime nga ana e IPK-së, 64 rekomandime për suspendime dhe 13 rekomandime për transfer.

Gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2015 IPK-ja ka trajtuar 550 ankesa, prej të cilave 285 janë klasifikuar si shkelje disiplinore dhe i janë referuar Drejtorisë së Standardeve Profesionale të PK-së, kurse rastet e tjera janë duke u trajtuar në Inspektoratin Policor të Kosovës.

Gjatë gjashtëmuajorit të parë të 2015-s janë suspenduar 18 punonjës të Policisë së Kosovës që në krahasim me vitin e kaluar për periudhën e njëjtë kohore, është më i vogël.

“Integriteti”: Në bazë të inspektimeve dhe veprimeve të tjera që ndërmerrni ndaj policisë, sa është ky institucion i sigurisë duke i luftuar dukuritë negative

brenda saj?

Shishani: Mendoj se vullneti për një gjë të tillë nuk mungon nga ana e PK-së. E kam theksuar shumë shpesh në shumë konferenca të organizuara për integritetin policor dhe po theksoj edhe tani, policia duhet të angazhohet shumë edhe nga aspekti vetjak. Sa më shpejt që është e mundur duhet ndryshuar kultura organizative, e cila sigurisht se s'duhet të jetë statike, por të ndryshojë me kohën në bazë të sfidave, duke përfshirë metoda të reja pune dhe forma të reja performance.

Konsideroj se çdo drejtues (udhëheqës) në polici, duke mos përjashtuar as një funksion dhe gradë, duhet të ketë imagjinatë për zhvillimet dinamike brenda policisë dhe shoqërisë sonë në përgjithësi. Në disa raste disa veprime kundërligjore që mund t'i kryejnë pjesëtarët e policisë sonë, si një nga policitë më të mira në rajon, mund të paraqesin krizë momentale, mundet që policia ta ndjejë veten keq për disa veprime, po themi të këqija, që mund dikush nga radhët e tyre t'i kryejë, por luftimi me vendosmëri i këtyre dukurive nga vetë policia, jo vetëm që e ngrit imazhin pozitiv, por në aspektin tonë kombëtar, të raportimit para botës, në aspektin e strategjive të ndryshme, Kosova përfiton, sepse raportet që përpilohen për Kosovën do të cekshin se këto dukuri negative kanë ndodhur, por ja që janë luftuar.

(Kjo intervistë e zhvilluar nga gazetari Lirim Geci me disa ndryshime të vogla është publikuar në të përditshmen Epoka e Re)



Ky program i është dedikuar nxënësve të shkollave të mesme dhe qëllimi i organizimeve të tilla ishte sensibilizimi i të rinjve lidhur me çështjet aktuale si: siguria e komunitetit, rreziku nga kriminaliteti dhe ekstremizmi, migrimi jolegal, rreziku nga përdorimi i drogave, mundësitë për shkollim, dhe informacione të tjera që ndërlidhen me fushën e sigurisë

IPK PJESË E ORGANIZIMIT “AMERIKA ME KOSOVËN”

Në kuadër të angazhimeve për fuqizimin e bashkëpunimit me qytetarë në përgjithësi, e në veçanti me grupmoshat e reja, IPK mori pjesë në organizimin e Ambasadës Amerikane në Prishtinë, në programin “Amerika për Kosovën”. Zyrtarët e IPK-së morën pjesë në organizimin e njëjtë në tri qytete: në qytetin e Ferizajt - shkollën e mesme “Kuvendi i Arbrit”, në Gjilan - shkollën e mesme “Marin Barleti” dhe në Mitrovicë në shkollën e mesme “Frang Bardhi”.

Pjesëmarrës në këtë organizim ishin përfaqësues nga Ambasada Amerikane, Ministria e Punëve të Brendshme, Inspektorati Policor i Kosovës, Policia e Kosovës, zyrtarë komunal dhe organizata tjera pjesëmarrëse.

Ky program i është dedikuar nxënësve të shkollave të mesme dhe qëllimi i organizimeve të tilla ishte sensibilizimi i të rinjve lidhur me çështjet aktuale si: siguria e komunitetit, rreziku nga kriminaliteti dhe ekstremizmi, migrimi jolegal, rreziku nga përdorimi i drogave, mundësitë për shkollim, dhe informacione të



tjera që ndërlidhen me fushën e sigurisë.

Inspektorati Policor i Kosovës, gjatë këtij aktiviteti ka paraqitur para nxënësve materiale lidhur me veprimtarinë e IPK-së, si; revista, broshura dhe kartëvizita të cilat përmbajnë informacione për numrin pa pagesë të IPK-ë (080003333).

Gjatë organizimeve nxënësit shprehën interesim lidhur me fushë veprimtarinë e IPK-së duke parashtruar pyetje të ndryshme por edhe duke marrë përgjigje konkrete.





IPK dhe SHÇBA me marrëveshje bashkëpunimi

Qeveria e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë kanë nënshkruar 12 marrëveshje bashkëpunimi në mbledhjen e përbashkët të mbajtur në Pallatin e Kongreseve në Tiranë. Marrëveshjet e nënshkruara nga Kryeministrat e dy vendeve kanë të bëjnë me fushën e sigurisë, tregtisë, bujqësisë, arsimit dhe kulturës. Në mesin e 12 marrëveshjeve është edhe memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Punëve

të Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës në Kosovës mbi Forcimin e Bashkëpunimit në Fushën e Kontrollit të Brendshëm. Ky memorandum ka për qëllim përmirësimin e bashkëpunimit në fushën e shërbimeve të kontrollit të brendshëm në të dy vendet, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të luftës kundër korrupsionit në radhët e policisë si

FUQIZOHET BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Si Inspektoratit Policor të Kosovës ashtu edhe Shërbimit për Çështje të Brendshme dhe Ankesa u mundësohet bashkëpunim i drejtpërdrejtë dhe mbështetje reciproke, në fushën e asistencës teknike dhe ndërtimit të kapaciteteve si instrumente kryesore të luftës kundër korrupsionit



dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të individit.

Marrëveshja mundëson sigurimin e një platforme për shkëmbimin e informacionit dhe ekspertizës në lidhje me çështjet e mbikëqyrjes policore dhe anti-korrupsion, nëpërmjet takimesh në nivel ekspertësh.

Si Inspektoratit Policor të Kosovës ashtu edhe Shërbimit për Çështje të Brendshme dhe Ankesa u

mundësohet bashkëpunim i drejtpërdrejtë dhe mbështetje reciproke, në fushën e asistencës teknike dhe ndërtimit të kapaciteteve si instrumente kryesore të luftës kundër korrupsionit.

Marrëveshja parasheh edhe veprime operacionale të përbashkëta, për zbulimin, dokumentimin dhe goditjen e veprimtarisë anti-ligjore të kryer nga punonjës policie të dy vendeve si Kosovës ashtu edhe Shqipërisë. Përveç marrëveshjeve, janë nënshkruar edhe dy protokolle ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës



së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës në Kosovës, njëri për ndjekjen e menjëhershme ndërkufitare, kurse tjetri për shfrytëzimin e përbashkët të pajisjeve për kontrollin e kufirit.

IPK PËRFUNDOI INSPEKTIMIN PËR ZBATIMIN E R



Si pjesë e autorizimeve ligjore, SIPK realizon gjatë vitit disa inspektime të strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës (PK) për të siguruar llogaridhënie, efektivitet dhe efikasitet në zbatimin e ligjeve, akteve nënligjore dhe procedurave standarde të operimit në fuqi. Raportet e inspektimit theksojnë qartë kriteret objektive të gjendjes dhe përmbajnë rekomandime për adresimin e çdo rrethane që në mënyrë negative ndikon në efektivitetin e policisë dhe performancën e saj. Departamenti i Inspektimeve këtë vit

ka realizuar një inspektim përcjellës të strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës për të siguruar se rekomandimet e IPK-së zbatohen, dhe se implementimi i tyre sjell llogaridhënie, efikasitet dhe efektivitet në Policinë e Kosovës. Udhëheqësi i Departamentit të Inspektimeve - Arben Vrajolli, në një prononcim për revistën “Integriteti” theksoi se inspektimet përcjellëse janë të rëndësishme si për IPK-në ashtu edhe për PK-në: “Funksionalizimi i inspektimeve përcjellëse nga IPK-ja, nënkupton se Inspektorati Policor përveç se kryen inspektimet për të vlerësuar

performancën e PK-së, përkujdeset që të vlerësojë se sa ato rekomandime implementohen dhe përmes këtyre inspektimeve shikohet se cili është niveli i implementimit të tyre” – theksoi Vrajolli. Si rezultat i këtij inspektimi, është përgatitur një raport, i cili përfshinë të gjeturat dhe rekomandimet e dhëna për përmirësimin e gjendjes së gjetur në 10 inspektime të kryera gjatë viteve 2012-2013. Qasja e prezantimit të të gjeturave në këtë raport është bazuar në rrethanat dhe sfidat me të cilat përballet PK-ja dhe si kanë mundur të njëjtat të ndikojnë në implementimin e

EKTIMIN PËRCJELLËS REKOMANDIMEVE



rekomandimeve që kanë dalë nga IPK-ja.

Në këtë mënyrë, të gjeturat në këtë raport janë prezantuar si të gjetura se cilat nga rekomandimet janë implementuar në tërësi, cilat janë implementuar pjesërisht dhe cilat nuk kanë arritur të implementohen fare. Ky inspektim përcjellës i IPK-së njëherit luan rol të rëndësishëm edhe në ushtrimin e kontrollit tek menaxhmenti policor për të siguruar se rekomandimet e IPK-së janë duke u implementuar nga PK-ja si dhe në ngritjen e përgjegjësisë së menaxhmentit policor me qëllim të angazhimit maksimal për të jetësuar rekomandimet.



Gjatë këtij inspektimi IPK ka vlerësuar implementimin e rekomandimeve të 10 inspektimeve të realizuara gjatë periudhës kohore 2012-2013 si në vijim:

1. Identifikimi dhe Vlerësimi i Procedurave të Arrestim- Ndalimit në Policinë e Kosovës.
2. Ekzekutimi i Urdhërësive dhe Letër-rreshtimeve nga Policia e Kosovës –Stacioni Policor Gjakovë.
3. Menaxhimi i Policisë Kufitare.
4. Kryerja e Detyrave Policore në Planifikimin, Furnizimin, Mirëmbajtjen dhe Menaxhimin e Flotës Operative të Policisë së Kosovës.
5. Vlerësimi i Procedurave të Hetimit të Rasteve të Aksidenteve të Trafikut në Policinë e Kosovës.
6. Vlerësimi i Shpërndarjes së Personelit në Policinë e Kosovës.
7. Inspektimi i Performancës Policore të Njësiave Speciale Operative.
8. Vlerësimi i Kushteve Materiale dhe Aspektit të Sigurisë në Qendrat e Mbajtjes në Policinë e Kosovës.

9. Dhomat e Dëshmime në Policinë e Kosovës.

10. Vlerësimi i Performancës, Gatishmërisë, Trajnimeve dhe Kushteve të Punës në NJSI-së.

Të gjeturat e këtij inspektimi përcjellës tregojnë se nga gjithsej dhjetë (10) inspektime të realizuara në periudhën kohore 2012-2013, prej të cilave kishin dalur (84) Rekomandime të cilat ishin në fokus të këtij inspektimi përcjellës, dyzetë e gjashtë (46) janë implementuar plotësisht, tridhjetë e gjashtë (36) janë implementuar pjesërisht kurse dy (2) prej tyre nuk kanë arritur të adresohen.

IPK planifikon që inspektime të tilla të jenë të rregullta përcjellëse për të ndikuar në rritjen e efektivitetit dhe performancës së policisë:

“Këto inspektime do të jenë të rregullta dhe do të zbatohen së paku një herë në dy vite kur do të vlerësohet niveli i implementimit të rekomandimeve nga PK-ja për periudha të caktuara kohore” – theksoi Udhëheqësi i Departamentit të Inspektimeve z. Vrajolli.



BASHKËPUNIMI ME QYTETARË NË FOKUS TË IPK-SË



Inspektorati Policor i Kosovës, në bashkëpunim me ICITAP –in dhe Divizionin për Siguri në Bashkësi të MPB-së, Policinë e Kosovës dhe EVSB-të (Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi), ka planifikuar organizimin e disa aktiviteteve

(tryezave të rumbullakëta) nëpër Komunitet të Kosovës. Organizimi i aktiviteteve të tilla ka për qëllim që Inspektorati Policor i Kosovës, të jetë më afër qytetarëve të Kosovës duke ofruar informacione për fushë-

veprimtarinë e IPK-së dhe projektet e iniciuara si “Kutia e Ankesave” dhe “Linja e kaltër”. Deri në muajin korrik janë organizuar tri takime të tilla në Gjakovë, Vushtrri dhe në Gjilan. Gjatë aktiviteteve të organizuara

Fushëveprimtaria dhe projektet e IPK-së shpjegohen te qytetarët e Gjakovës, Vushtrrisë dhe Gjilanit



në këto komuna janë diskutuar çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me fushën e mbikëqyrjes policore dhe fushës së sigurisë publike në përgjithësi.

Në takimin e mbajtur në Gjilan, kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Gjilanit, Valentina Bunjaku

– Rexhepi, duke potencuar se gjendja në aspektin e sigurisë në Gjilan në përgjithësi është shumë e qetë, ka falënderuar IPK-në për një organizim të tillë që ka bashkuar zyrtarët komunal, qytetarët dhe forumet e sigurisë për të diskutuar për fushë-

veprimtarinë e IPK-së.

IPK falënderon për përkrahjen e dhënë drejt realizimit të këtij aktiviteti zyrtarët e ICITAP-it, MPB-së, Policinë e Kosovës, Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi dhe Kuvendin Komunal të Gjakovës, Vushtrrisë dhe Gjilanit.





SYLË HOXHA



FITIM SHISHANI



RAMADAN MUJA

IPK SHTRIHET NË R

INSPEKTORATI POLICOR HAP ZYRAT RAJONALE NË GJ

Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) hapi zyrat e para rajonale. Iniciativa e tillë e IPK-së është bërë për të realizuar me sukses misionin ligjor të saj, në përputhje edhe me vizionin e IPK-së, për të ofruar një shërbim më efikas dhe më efektiv të qytetarët e vendit, për të zvogëluar edhe kohën e reagimit në raste të caktuara, dhe për të ndikuar edhe si mjet preventiv.

Në ceremonitë e organizuara nga IPK-ja për hapjen e zyrave në Gjilan dhe në Prizren, të pranishëm ishin

përfaqësues të Prokurorisë, avokatit të popullit, Agjencisë së Regjistrimit Civil, Policisë së Kosovës, përfaqësues të Komunave, si dhe përfaqësues të ICITAP-it amerikan dhe EULEX-it. Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së, z. Fitim Shishani në fjalën e tij të rastit duke falënderuar të gjithë të pranishmit ceku rëndësinë e hapjes së kësaj zyre:

“IPK jo vetëm që është forcuar në nivel qendror por ka ardhur momenti që ne me profesionalizmin tonë, me

përkrahjen e organizatave vendore dhe ndërkombëtare si ICITAP , por edhe të hapim zyrën tonë të parë rajonale ku do të trajton ankesat e qytetarëve”- theksoi Kryeshefi Ekzekutiv.

Në fjalimin e tij ai paralajmëroi edhe hapjen e zyrave tjera të IPK-së në rajonet tjera dhe potencoi dy arsye kryesore për hapjen e zyrave rajonale:

“Arsyeja e parë është që IPK të jetë më afër qytetarëve kurse arsyeja



Projekti i regjionalizimit të IPK-së synon fuqizimin e bashkëpunimit me qytetarë duke dhënë një mundësi shtesë për denoncimin e ankesave dhe rasteve të ndryshme me elemente të veprave penale në tërë territorin e Kosovës si dhe një mundësi për kualitet më të lartë të mbikëqyrjes policore

e dytë është ruajtja dhe fuqizimi i kredibilitetit të Policisë së Kosovës”- theksoi Kryeshefi Shishani duke falënderuar në veçanti edhe Agjencinë e Regjistrimit Civil e cila ka siguruar hapësirën për këto zyre në objektin e saj në Gjilan dhe Prizren.

Hapjes së zyrës së IPK-së ju gëzua

AJONE ILAN DHE PRIZREN

Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) ka filluar së zbatuari projektin për regjionalizimin i cili përfshin hapjen e zyrave rajonale me qëllim që të jetë sa më afër qytetarëve si dhe të ndikojë që Policia e Kosovës të jetë sa më profesionale

edhe Prokuroria e Gjilanit dhe ajo e Prizrenit .

Jetish Maloku, Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Gjilan ka thënë se me hapjen e kësaj zyre do të intensifikohet bashkëpunimi me Inspektoratin Policor:

“Edhe kur ka qenë moment i caktimit të prokurorëve si koordinator për bashkëpunim me IPK-në ka qenë Gjilani që i ka paraprirë këtij procesi. Më vjen mirë që tani edhe zyra e parë e IPK-së po inaugurohet në Gjilan dhe tash që ju kemi më afër do të ketë një bashkëpunim më të madh dhe ky bashkëpunim do të jetë më i frytshëm”, ka thënë ai.

Ndërsa Z.Sylë Hoxha Kryeprokuror i Prokurorisë në Prizren hapjen e kësaj konsideroi si fuqizim i bashkëpunimit me Inspektoratin Policor:

“Edhe për ne si Prokurori në Prizren hapja e zyrës është lajm i mirë pasi që do të jemi më afër me rastet që trajton IPK-ja” theksoi Kryeprokurori Hoxha në ceremoninë e organizuar në Prizren duke shprehur kënaqësinë e tij për profesionalizmin dhe përkushtimin e

punonjësve të IPK-së drejt realizimit të objektivave ligjore.

Kryetari i Komunës së Prizrenit z. Ramadan Muja potencoi se hapja e kësaj zyre është e mirëpritur nga qytetarët e Prizrenit dhe 74 fshatrat e zonës së Prizrenit.

Kurse përkrahjen për funksionimin e zyrës së IPK-së në Gjilan premtoi edhe nënkryetari i Komunës së Gjilanit z. Rexhep Kadriu i cili potencoi se hapja e kësaj zyre do të ndikojë që qytetarët të ndihen edhe më të sigurt.

Zyra rajonale e IPK-së e cila ka filluar punën që nga sot gjendet në objektin e Agjencisë së regjistrimit Civil në Prizren afër objektit të Administratës Tatimore në Prizren në rrugën “Kukësi”.

Inspektorati Policor i Kosovës do të vazhdojë me përkushtim të angazhohet duke ndihmuar në përmirësimin dhe ngritjen e cilësisë së punës së Policisë së Kosovës dhe për të mbrojtur liritë dhe të drejtat e qytetarëve të Republikës së Kosovës përmes ofrimit të shërbimeve sa më afër qytetarit.





An EU funded project
managed by the
European Union Office in Kosovo

EU Twinning Projekt "Strengthening Criminal
Investigation Capacities against Organised
Crime and Corruption"



INSPEKTORATI POLICOR SHKËMBEN PËRVOJAT ME HU



Partnerët e Projektit të Binjakëzimit bazuar në propozimet e përfituesve të projektit dhe analizave paraprake, kanë vendosur që disa zyrtarë nga institucionet përfituese, të bëjnë një vizitë studimore në Hungari si pjesë e zbatimit të procedurave të Sistemit të Menaxhimit të Integritetit brenda Policisë së Kosovës (PK).

Gjatë vizitës katër ditore pjesëmarrësve ju prezantuan detyrat e Policisë Kombëtare të Hungarisë, dhe procedurat e njësisë së ngjashme

me Drejtorinë e Standardeve Profesionale.

Vizita studimore gjithashtu pritet të ndikojë në fuqizimin i bashkëpunimit kombëtarë, rajonal dhe ndërkombëtarë në luftën kundër korrupsionit, krimin të organizuar dhe krimin financiar duke vizituar agjencitë e zbatimit të ligjit të Hungarisë dhe duke shkëmbyer përvojat me ta.

Në mënyrë që të ofrohen praktikat dhe shembujt më të mirë të BE-së për menaxhimin e integritetit dhe luftën kundër krimin të organizuar

ndërkombëtarë, organizatorët në kuadër të Projektit të binjakëzimit të titulluar "Fuqizimi i kapaciteteve për hetime penale kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit", kanë parë të rëndësishme që partnerëve të ju prezantohen proceset në mënyrë të drejtpërdrejt ose thënë më thjeshtë duke prezantuar praktikat më të mira.

Dy zyrtarët nga Inspektorati Policor i Kosovës, Ridvan Kajtazi dhe Safet Hoti, që ishin pjesëmarrës në këtë vizitë studimore shprehën rëndës-



LICOR NGARINË

Zyrtarë të IPK-së dhe PK-së përfunduan vizitën studimore në Hungari për Menaxhimin e Integritetit dhe Sistemin e menaxhimit të masave disiplinore në Policinë Hungareze, dhe për metodologjinë e bashkëpunimit ndërkombëtarë

inë e shkëmbimit të përvojave me shtetet e BE-së:

“Shkëmbimi i përvojave me kolegët e Hungarisë ishte shumë e dobishme për ne. Gjatë takimeve që kemi zhvilluar me zyrtarë të institucioneve të sigurisë këtu, kemi kuptuar se

IPK mund të adaptojë edhe më shumë praktika të mira që mund të ndikojnë në fuqizimin e integritetit në polici” theksoi Ridavn Kajtazi.

Gjatë qëndrimit katër ditor në Hungari, zyrtarët te IPK-së dhe të PK-së vizituan edhe institucionin e

Mbrojtjes Shtetërore për hetimin e korrupsionit e cila ka të njëjtin funksion si IPK-ja por me kompetenca të zgjeruara pasi që kompetencë e saj është hetimi i punonjësve të policisë, zjarrfikësve, zyrtarëve komunal etj.





IPK SHËNON NËNTË VJETORIN E THEMELIMIT

Inspektorati Policor i Kosovës në një ceremoni të organizuar me shumë aktivitete ka shënuar nëntë vjetorin e themelimit.

Në këtë ceremoni morën pjesë përfaqësues të lartë të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, përfaqësues të institucioneve që ndërliken me fushën e sigurisë, gjyqësisë, prokurorisë si dhe përfaqësues nga Shërbimi për Çështje të Brendshme dhe Ankesa të Republikës së Shqipërisë etj.

Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së z. Fitim Shishani duke falënderuar të gjithë të pranishmit theksoi se rrugëtimi i IPK-së ndër vite ishte përplot sfida e suksese: “Është e pamundur që

IPK për nëntë vite ka ndërtuar një reputacion dhe atë jo vetëm brenda institucioneve të Kosovës por edhe në rajon

në përvjetorë të mos i kujtojmë rezultatet dhe sfidat duke llogaritur edhe kontributin e secilit pjesëtar të IPK-së me të cilët jam shumë krenar. Të mbikëqyrësh një institucion si Policia e Kosovës nuk është punë e lehtë, por ne do të vazhdojmë

angazhimet tona duke qenë çdo herë të përgatitur, profesional dhe objektiv” – theksoi ndër të tjera z. Shishani duke potencuar se rrugëtimi i IPK-së deri në këtë fazë të sotme u mundësua edhe nga përkrahja e institucioneve vendore e ndërkombëtare siç është ICITAP. Përfaqësuesi i ICITAP-it z. Ron Fisher, i cili pranoi një mirënjohje për përkrahjen e vazhdueshme të IPK-së, theksoi se ndjehet krenar për arritjet e IPK-së:

“Ambasada Amerikane dhe ICITAP-i janë shumë krenar për punën që bën IPK, kur i mendon 9 vite që kanë kaluar, IPK ka evoluar shumë duke u bërë një organizatë e qëndrueshme



për të vazhduar para me kapacitetet e saj të brendshme. IPK ka ndërtuar një reputacion dhe atë jo vetëm brenda institucioneve të Kosovës por edhe në rajon” theksoi z. Fisher.

Në shenjë mirënjohjeje për përkrahjen e dhënë në ngritjen e nivelit të profesionalizmit të IPK-së, mirënjohje u ndanë edhe për përfaqësuesin e EULEX-it z. Hendrik Groeneveld, Prokurorisë së Shtetit - z. Sylë Hoxha, përfaqësuesit të DCAF-it znj Luanda Domi dhe përfaqësuesit të OSBE-së z. Henrik Malmquist.

Gjatë ceremonisë së organizuar për këtë rast, të gjithë punonjësve operativ të IPK-së u ndanë distinktivët e rinj. Si pjesë e aktiviteteve për të shënuar nëntë vjetorin e IPK-së, pasi që 1 Qershori është edhe dita ndërkombëtare e fëmijëve, mbi 30 punonjës të IPK-së dhuruan vullnetarisht gjak për fëmijët në nevojë. Para fillimit të ceremonisë zyrtare, mbi 40 nxënës të shkollës fillore “Shkëndija” të Hajvalisë vizituan Inspektoratin Policor të Kosovës, kum morën informacione lidhur me fushë-veprimtarinë dhe misionin e IPK-së. IPK u themelua në vitin 2006 si një mekanizëm i pavarur i mbikëqyrjes së Policisë me dy funksione kryesore: inspektimi i mënyrës së kryerjes së detyrave nga ana e Policisë në një varg të definuar të funksioneve menaxhuese, në lidhje me saktësinë, efektshmërinë dhe zbatueshmërinë e ligjeve në fuqi dhe hetimin e të gjitha ankesave për sjellje të policëve, pa dallim grade.



RAPORTI I VLERËSIMIT TË PECK-ut KUNDËR KORRUPSIONIT

**“EKIPI I VLERËSIMIT – IPK KOHËVE TË FUNDIT KA KALUAR NËPËR
REFORMA TË MËTEJME ORGANIZATIVE DHE STRUKTURORE
NË MËNYRË QË TA ZHVILLOJË MË TEJ EFEKTIVITETIN DHE
EFIKASITETIN”**

Në vitin 2012, Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës, së bashku me autoritetet e Kosovës, kanë ndërmarrë një aktivitet që ka qenë unik në shumë aspekte. Në kuadër të Projektit të bashkë-financuar kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (PECK), për herë të parë, Kosova u bë subjekt i një vlerësimi gjithëpërfshirës dhe të strukturuar të kornizave të veta kundër korrupsionit (KK) dhe kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (LPP/LFT).

Ky projekt me kohëzgjatje 2012 – 2015, është bashkë-financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës. Këshilli i Evropës ishte përgjegjës për zbatimin e projektit në kuadër të marrëveshjes së Komunitetit Evropian me Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë.

Ekipi i Vlerësimit është takuar me zyrtarë të organizatave të ndryshme qeveritare ndër ta edhe me zyrtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe agjencive në kuadër të saj si Inspektorati Policor (IPK), Policia e Kosovës (PK), dhe


Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), pastaj Agjencisë së Kosovës kundër Korrupsionit (AKK), Prokurorisë së Shtetit (PSh), Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK), Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Gjykatës Kushtetuese (GJK).

Vlerësimi është bazuar në metodologjitë e zbatuara nga organet monitoruese evropiane për të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Janë zhvilluar dy cikle të vlerësimit, që kanë përfshirë

fushat institucionale, ligjore politike dhe operative të ndara në tema të veçanta. Vlerësimi është modeluar kryesisht sipas Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit të Këshillit të Evropës - GRECO dhe Komisionit të Ekspertëve mbi Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit - MONEYVAL.

Ekspertët e kanë shqyrtuar kornizën juridike (ligjet, rregulloret, udhëzimet përkatëse dhe kërkesat e tjera), kornizën e politikave, kornizën institucionale dhe sistemet

Ekipi i vlerësimit i mirëpret zhvillimet dhe hapat e fundit që kanë për qëllim shtimin e efikasitetit për fuqizimin e kornizës juridike dhe rregullative si dhe të procedurave standarde të operimit dhe përmirësimin e monitorimit efektiv të veprimeve policore, përshirë procedurat disiplinore për sjellje jo të duhura etike dhe hetimin e akteve të korrupsionit.



Inspektorati Policor të Kosovës është vlerësuar lartë edhe për mbajtjen e statistikave mbi masat disiplinore madje është marrë si shembull pozitiv duke u rekomanduar institucioneve të tjera që të ndjekin shembullin e njëjtë. Po ashtu, është vlerësuar edhe bashkëpunimi i IPK-së me gjykatat, përkatësisht krijimi i pikave të kontaktit për shkëmbimin e informacioneve ne mes IPK-së dhe gjykatave lidhur me rastet e trajtuara

e themeluara për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit si dhe i kanë shqyrtuar kapacitetet, zbatimin dhe efektivitetin e sistemeve e të mekanizmave ekzistues. Nga takimet e zhvilluara me stafin menaxhues të IPK-së, Ekipi i Vlerësimit është informuar për të arriturat dhe sfidat me të cilat po përballet IPK. Ekipi i Vlerësimit në raport theksoi se IPK-ja kohëve të fundit ka kaluar nëpër reforma të mëtejme organizative dhe strukturore në mënyrë që ta zhvillojë më tej efektivitetin dhe efikasitetin e vet. Kështu që, përveç kompetencave për procedurat disiplinore, me kornizën e saj të tanishme juridike IPK-së i është besuar edhe kryerja e hetimeve penale kundër zyrtarëve policorë. Ekipi i Vlerësimit i mirëpret zhvillimet dhe hapat e fundit që kanë për qëllim shtimin e efikasitetit për fuqizimin e kornizës juridike dhe rregullative si dhe të procedurave standarde të operimit dhe përmirësimin e monitorimit efektiv të veprimeve policore,

përshirë procedurat disiplinore për sjellje jo të duhura etike dhe hetimin e akteve të korrupsionit. Përveç të arriturave, Ekipi i Vlerësimit ka evidentuar edhe fushat në të cilat ka nevojë për angazhime shtesë. Ekipi nënvizon se zbatimi i masave disiplinore mbetet ende një sfidë dhe hetimet penale duhet të adresohen më mirë. Ende mbetet për tu verifikuar nëse organet relevante policore të hetimeve disiplinore dhe të brendshme janë të (apo janë në proces e sipër) pajisur me staf të duhur në mënyrë që të kenë mundësi të zhvillojnë ose hetimet efikase të brendshme penale për akuzat e korrupsionit kundër zyrtarëve të policisë ose të zbatojnë procedura disiplinore. Poashtu, Ekipi i Vlerësimit thekson nevojën e zhvillimit të metodologjisë së "historikut" të bazuar në ekzaminime analitike dhe që synon ofrimin e rezultateve konkrete për procedimin e mëtutjeshëm të masave disiplinore apo hetimeve penale. Raporti vjetor duhet të përfshijë informacione të kompletuara mbi

sanksionet/vendimet e shqiptuara kundër punëtorëve të Policisë së Kosovës që kanë qenë nën hetim, edhe nga Departamenti për Standarde Profesionale për rastet disiplinore, edhe nga Prokuroria apo Gjykatat për vepra penale. Vlerësimi i thukët i historisë disiplinore mund të shërbejë si bazë për ta ndryshuar legjislacionin aktual apo për ta hartuar një të ri. Ndërsa në raportin lidhur me Përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare (LPP -Luftimit kundër pastrimit të parave dhe LFT- Luftimi kundër financimit të terrorizmit), Ekipi i vlerësimit thekson nevojën për zgjerimin e rolit të IPK-së. Që të dy raportet e plota mund ti gjeni në ueb faqen e IPK-së: <http://ipk.rks-gov.net/>

“LINJA E KALTËR” NË TËRË KOSOVËN



Në fillim të këtij viti Inspektorati Policor i Kosovës ka lëshuar në përdorim numrin pa pagesë 080003333 për qytetarët e Republikës së Kosovës. Për këtë numër, që si projekt është titulluar si “Linja e kaltër”, janë realizuar edhe fushata me ndihmën e partnerëve ndërkombëtar si KFOR-i dhe EULEX-i, të cilët kanë përkrahur

IPK-në me audio dhe videospote. Përveç tyre, ky projekt ka përfshirë edhe vendosjen e posterëve në stacione policore dhe në të gjitha pikëkalimet kufitare. Edhe “Linja e kaltër” si projekt, por edhe motoja e vendosur në këta posterë flet për angazhimet e IPK-së drejt fuqizimit të bashkëpunimit me qytetarë me

moton “Së bashku për një polici profesionale”. Për realizimin e këtij projekti Inspektorati policor i Kosovës ka bashkëpunuar edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës, lidhur me vendosjen e posterëve në objektet e Drejtorive Rajonale, respektivisht stacioneve policore si dhe në të gjitha pikë kalimet kufitare.





Edhe këtë vit mirënjohje për sportistët e dalluar

Me rastin e përvjetorit të nëntë të themelimit, Inspektorati Policor i Kosovës ka organizuar aktivitete të shumta. Interesimi nga punonjësit e IPK-së, sidomos në garat sportive, ishte mjaft i madh.

Departamenti i Hetimeve (Jetullah Aliu) ishte fitues në garën në Ping Pong, Departamenti për financa dhe Shërbimet e Përgjithshme fitoi kupën në futboll të vogël, kurse në garën "Gjuajtje me armë zjarri", kupën e fitoi Departamenti i Inspektiveve (Arben Vrajolli).

Pamjet si më lart tregojnë për aktivitetet e organizuara për nder të përvjetorit të nëntë të IPK-së.



Dhuroni gjak, shpëtoni jetë!

Njëri ndër aktivitetet e organizuara në IPK ishte edhe dhurimi vullnetar i gjakut, i cili u organizua në bashkëpunim me Qendrën e Transfuzionit të Gjakut të Republikës së Kosovës.

Pasi që organizimi u bë në Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, mbi 30 punonjës të IPK-së, shprehën gatishmërinë për dhurimin vullnetar të gjakut për fëmijët në nevojë.



Vizita e nxënësve në IPK


Mbi 40 nxënës të shkollës fillore "Shkëndija" të Hajvalisë vizituan Inspektoratin Policor të Kosovës ku morën informacione lidhur me fushë-veprimtarinë dhe misionin e IPK-së.

Gjatë kësaj vizite, nxënësit kishin mundësinë të parashtronin pyetje nga më të ndryshmet lidhur me IPK-në, kurse interesimit të tyre iu përgjigjen zyrtarët e IPK-së.

IPK ME UEB TË RI

Dizajni i ri i Ueb faqes së IPK-së është ri-dizajnuar në atë mënyrë që të jetë më lehtë i qasshëm për qytetarët dhe që atyre t'ju ipet një mundësi më e mirë e informimit rreth IPK-së.

Me dizajnin e ri të ueb-it edhe ankesat e qytetarëve tani janë më mirë të menaxhuara si rezultat i platformës së re.



<http://ipk.rks-gov.net/>